MOT' I PARƐ — 1 MARS 1909. — № 3.

# DITURIJA

## E PƐRKOHƐϬME ϬQIP LITERARE БE DITURAKE

**DEL ИƐ HERƐ NƐ MUAJ**

*Dreqtoηεs:* Lumo Skεndo

MBAN:

Ϭqipεtarεt ger mε tani δe paskεtaj: Lumo Skεndo.— Fjalεtore e vogεlε. — Tingλim: Z. G. — Trimi Ϭqipεtar: Tom. — Qetεsi e zεmrεs: F. — Kongres' i Manastirit. — Qieλi δe yjtε: L. S. Helen Keller. — Uδεtim i ϭpesεvet. — Andej Kεtej. Pjesa ϭtεpiake. — Bibliografi.

Ky numur mban 2 fytyra tε ϭtypura veç.



SELANIK

# DITURIJA

## ϬQIPETARET

### ΓER ME TANI БE PASKETAJ

Nga kaqε kombe qε jan' nε Tyrqi Ϭqipεtarεt jan' ata qε kanε lojturε mê tε maðin rol. Pas ƞezet e pes vjet luftε nεnε flamur tε ndriçim tε Skεnderbeut, ðe pas ƞε kundrεqεndrimi tε nderçim. Ϭqipεrija hyri nεnε sunim tε Tyrqisε, jo si ƞε vεnt i mundurε, po si ƞε komp ϭok ðe baras.

Ca kombe tε tjerε si Sεrbεrit, i treguanε Tyrqisε ƞε kundrεqεndrim mê tε mað, po passi u-muntnε hynε fare nεnε qeveri tε Tyrqisε, pa ruajtur as ƞε farε venomi. Ϭqipεrija munt tε ðemi se ka qεn' i vetεmi vεnt qε ka mbajturε lirinε ðe zakonet e saj: Tyrqija veç emrin kiϭ mi vεndin tεnε, se qeveri e vεndit ka mbeturε kurdoherε nε duar tε Ϭqipεtarεvet, tε fεmijεvet tε vεndit, qε kanε mbajturε ger fort afrε mεvethεsin' e tyre, aqε sa qeveri e Tyrqisε s' kiϭ as ƞε fuqi nε Ϭqipεri.

Ca vεnde tε tjerε, si Qyrdistani ðe mez' i Arabisε, kanε mbeturε ðe ata gysεm mε vethe; po kur ata kan ndεƞturε si tε ϭuarε, Ϭqipεtarεt i ϭohim qε kurdoherε kanε mbajturε ƞε vεnt tε ndriçim ðe tε nderçim.

Иε vεϭtrim i çpejttε n' istori tε Tyrqisε na tregon fort bukurε raðεn e çkεlqyerε qε kanε mbajturε Ϭqipεtarεt. Ϭqipεrija jo vetεm ka qεn' e zoƞa tε mbaƞε vethen' e saj tε lirε ðe tε pa poϭtεruarε, po ðe ka diturε qε tε jet' i par' i kombevet nε tε tεrε mbretεrit, duke ϭikuarε giðε Tyrqinε si ƞε vεnt tε hapurε pεr té, ku jo vetεm ka punuarε, ka fituarε, po ka urðεruarε ðe mbretεruarε.

Sa ƞeres tε mbεðeƞ kan' nxjerε giðε baϭkε kombet e tjerε tε Tyrqisε, Ϭqipεrija vetεm ka nxjerε mê tepεrε burra qε kanε ϭpεnε lark emrin' e Ϭqipεrisε ðe tε mbretεrisε.

Kur Tyrqija kiϭ arðurε me ƞε ϭkaλε fare tε dobεt, kur e tεrε mbretεrija iϭ afεruarε priϭjesε ðe greminεs, ƞε dorε çqipεtare, Mehmet paϭ Qypriliu, nga pϭatrat e Beratit, e ngre ðe i jep ƞε jetε, ƞε fuqi tε re! I bir' i Mehmet paϭεs, Fazil paϭa, ϭpie uϭtεrit e Tyrqisε ðeλε nε Austri e nε Rusi ðe tregon sa ƞε ƞeri i mað e i mεnçim εϭt' i zoti qε tε ngaλƞε ƞε mbretεri gysεm tε vdekurε!

Ca mê parε ƞε Ϭqipεtar tjatrε, Sinan paϭa, kiϭ ϭpεn' armεt mundεse tε Tyrqisε nε Jemen e nε ϭkretira t' Arabistanit.